



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 23 nëntor 2020
Nr. ref.:RK 1645/20

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastet nr. KI78/20, KI79/20 dhe KI80/20

Parashtrues

Hilmi Aliu dhe të tjerët

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar
të autoritetit publik**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI78/20 është parashtruar nga Hilmi Aliu, me vendbanim në Komunën e Prishtinës. Ndërsa kërkesat KI79/20 dhe KI80/20 janë parashtruar nga Hilmi Aliu në emër të Vehbi Aliut dhe Lumturije Aliut (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston asnjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së akteve të paspecifikuara të autoriteteve publike. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) pretendon se i janë cenuar përmes ndonjë akti të një autoriteti publik.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) e 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) e 35 (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 maj 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesat e lartcekura përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 12 qershor 2020, në pajtim me paragrafin 1 të rregullit 40 (Bashkimi dhe ndarja e kërkesave) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesave KI79/20 dhe KI80/20 me kërkesën KI78/20.
7. Më 12 qershor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.
8. Më 18 qershor 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që: (i) të plotësojë dhe firmosë formularin zyrtarë të kërkesës; (ii) të specifikojë aktet e autoriteteve publike të cilat i konteston; (iii) të qartësojë saktësisht pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë; (iv) t'i dorëzojë kopjet e dokumenteve dhe informatave tjera që mbështesin pretendimet e tij; dhe (v) të sqarojë se në çfarë kapaciteti ka dorëzuar në Gjykatë kërkesën KI79/20 dhe KI80/20.
9. Më 15 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë disa dokumente që përmbajnë pohime shtesë lidhur me rastin e tij, por të cilat, nuk i adresuan kërkesat e Gjykatës për sqarim.

10. Më 28 shtator 2020, Gjykata i dërgoi sërish shkresë parashtruesit të kërkesës dhe kërkoi nga ai që informatat dhe dokumentet e kërkuara përmes shkresës së 18 qershorit 2020, t'i dorëzojë në Gjykatë brenda 7 (shtatë) ditësh.
11. Më 9 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një shkresë të titulluar "*Pyetje për Zonjën Arta Rama-Hajrizi*", përmbajtja e të cilës është e pakuptueshme dhe nuk adreson kërkesat e Gjykatës për sqarim.
12. Më 11 nëntor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

13. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se, në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte aplikuar për pensionin bazik të moshës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: MPMS).
14. Më 11 qershor 2006, MPMS-ja nxori një vendim përmes të cilit miratoi pensionin bazë të parashtruesit të kërkesës në shumën prej dyzet (40) euro në muaj.
15. Më 7 mars 2016, parashtruesi i kërkesës gjithashtu paraqiti kërkesën për njohjen e të drejtës për pensionin kontributpagues të moshës në MPMS.
16. Më 2 nëntor 2016, MPMS-ja përmes Vendimit [146089] refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, duke theksuar, ndër të tjera, se kërkesa e parashtruesit të kërkesës (i) nuk i plotëson kriteret e përcaktuara përmes nenit 8 (Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës) të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti; dhe (ii) Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues, lidhur me dëshmitë e mjaftueshme për nivelin e përgatitjes shkollë.
17. Më 2 dhjetor 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Këshillin e Ankesave pranë Departamentit të Pensioneve të MPMS-së kundër Vendimit të lartcekur duke pretenduar shkelje të së drejtës procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Vendimi i kontestuar i MPMS-së të shpallet i pavlefshëm dhe t'i njihet e drejta në pension kontributpagues.
18. Më 14 prill 2017, Këshilli i Ankesave pranë Departamentit të Pensioneve të MPMS-së refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe rrjedhimisht vërtetoi Vendimin e kontestuar të MPMS-së. Këshilli i lartcekur, ndër të tjera, arsyetoi se provat e paraqitura, respektivisht diploma e dorëzuar, nuk shërben si dëshmi e mjaftueshme për ta rikategorizuar parashtruesin e kërkesës në pensionin kontributpagues.
19. Më 3 nëntor 2017, kundër vendimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe

vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Bazuar në shkresat e lëndës, më 4 maj 2018, MPMS kishte paraqitur përgjigje në padi, duke propozuar refuzimin e kërkesës së parashtruesit të kërkesës dhe vërtetimin e Vendimit të Këshillit të Ankesave.

20. Më 22 nëntor 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A. nr. 1879/17] aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe ktheu Vendimin e Këshillit të Ankesave të 14 prillit 2017 në rivendosje.
21. Më 21 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti një kërkesë “*për nxjerrjen e aktit administrativ*”, bazuar në Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore. Nga shkresat e lëndës rezulton se MPMS mund të mos ketë vepruar në përputhje me Aktgjykimin [A. nr. 1879/17] e 22 nëntorit 2018.
22. Në shkresat e lëndës gjithashtu gjenden edhe dokumentet vijuese (i) Aktgjykimi [ARJ-UZVP. nr. 49/2019] i 21 marsit 2019, përmes të cilit është refuzuar e pabazuar kërkesa për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të Lumturije Aliut, përkatësisht bashkëshortes së të birit të parashtruesit të kërkesës. Ky proces gjyqësor ndërlidhet me kërkesën e Lumturije Aliut për anulimin e Vendimit [nr. 5025536] të 11 marsit 2016 të Departamentit të Administratës Pensionale të MPMS-së; (ii) Aktgjykimi [A. nr. 700/2014] i 21 janarit 2016 i Gjykatës Themelore përmes të cilit aprovohet si e bazuar kërkesëpadija e Lumturije Aliut për anulimin e Aktvendimit [nr. 5025536] të 18 marsit 2014 të MPMS-së dhe kthehet çështja në rivendosje në MPMS; (iii) Aktgjykimi [A. nr. 2006/2017] i 7 nëntorit 2018 i Gjykatës Themelore, i cili miraton si të bazuar padinë e Vehbi Aliut, përkatësisht të birit të parashtruesit të kërkesës, duke kthyer Vendimin e Divizionit të Ndihmave Sociale të MPMS-së në rivendosje; (iv) Aktvendimi [PPP. nr. 10/2019] përmes të cilit është refuzuar si e pabazuar prapësimi kundër Urdhrit për Përmbaerim [P. nr. 1130/2018] të 7 nëntorit 2018, që ndërlidhet me propozimin për ekzekutim të Kompanisë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike; (v) Kallëzimi penal [Nr. 2009-AF-1152] i 12 shtatorit 2009 kundër të dyshuarit N. N. për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë, siç është përcaktuar në nenin 253 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës; (vi) shkresë drejtuar Kryetarit të Gjykatës Supreme të 2 majit 2019, përmbajta e të cilës është e pakuptueshme; (vii) kërkesë drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit, përmbajta e të cilës është e pakuptueshme; (viii) ankesë drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës më 21 maj 2019, përmbajta e të cilës është e pakuptueshme; (ix) Vendim për Largimin e rastit nga Lista lidhur me Ankesën [nr. 167/2015], *Hilmi Aliu kundër Gjykatës Themelore*, të Avokatit të Popullit të 9 janarit 2018. Kjo shkresë duket se është e ndërlidhur me një Aktvendim tjetër të MPMS-së, përkatësisht Aktvendimin [nr. 18-00186] e 14 gushtit 2013 përmes të cilit duket se është ndërprerë pensioni për persona me aftësi të kufizuara, i të birit të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht Vehbi Aliut; (x) kërkesë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë të 28 qershorit 2017, përmbajta e të cilës është e pakuptueshme, por duket të jetë e ndërlidhur me pensionin për persona me aftësi të kufizuara për bashkëshorten e djalit të tij, përkatësisht Lumturije Aliu; dhe (xi) kërkesë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës, përmbajtja e të cilës është e pakuptueshme.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës thekson, ndër të tjera, si në vijim: (i) *“Gjykatë, unë nuk i kuptoj nenet, por kërkoj drejtësi në përputhje me ligjet që ju keni hartuar me Kushtetutën e Kosovës, por shteti nuk ju njeh, si dhe ligjet që ju bëni. Unë sigurisht që kam faktet dhe datat, por nuk kam as gjysmën e tyre tani sepse i kam lënë në gjykata, me falsifikime nga shteti në Komunën e Podujevës”*; dhe (ii) *“Ne dhamë gjak për drejtësi, por jo drejtësi për veten dhe familjet tona, ose për para dhe korrupsion”*.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

26. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale) dhe 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”.

[...].

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

27. Në kontekst të dispozitave të lartcekura, Gjykata thekson se bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 1 të nenit 47 dhe nenin 48 të Ligjit, palët para Gjykatës, duhet të kontestojnë një akt të një autoriteti publik. Për më tepër,

bazuar në nenin 48 të Ligjit, përpos specifikimit të aktit konkret të autoritetit publik i cili kontestohet, palët janë gjithashtu të detyruara që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë se u janë cenuar. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës, përkundër kërkesave të Gjykatës për sqarim, nuk ka sqaruar para Gjykatës (i) as aktin e autoritetit publik të cilin e konteston; dhe (ii) as nuk ka sqaruar se cilat të drejta dhe liri themelore pretendon se i janë cenuar.

28. Gjykata rikujton se kërkesën e parashtruesit të kërkesës e kishte pranuar më 21 maj 2020. Duke marrë parasysh që kërkesa nuk ishte e kompletuar, më 18 qershor 2020, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit dhe pikat (f) dhe (g) të paragrafit (2) të rregullit 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve) të Rregullores së punës, Gjykata i kërkoj parashtruesit të kërkesës, përveç tjerash, që të plotësojë kërkesën e tij, duke: (i) specifikuar aktet e autoriteteve publike të cilat i konteston; (ii) qartësuar saktësisht pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë; dhe (iii) dorëzuar kopjet e dokumenteve dhe informatave tjera që mbështesin pretendimet e tij. Më 15 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë disa dokumente shtesë të cilat, nuk adresuan kërkesat e shkresës së Gjykatës të 18 qershorit 2020. Për pasojë, Gjykata iu drejtua sërish parashtruesit të kërkesës me një kërkesë për sqarim më 28 shtator 2020. Në përgjigje të kësaj kërkesë, parashtruesi i kërkesës, para Gjykatës dorëzoi një shkresë të titulluar *"Pyetje për Zonjën Arta Rama-Hajrizi"*, përmbajtja e të cilës është e pakuptueshme dhe nuk adreson kërkesat e Gjykatës për sqarim.
29. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafit (5) të rregullit 35 të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 35
(Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

[...]

"(5) Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë, përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë kërkesën,".

[...]

30. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës, i mundëson Gjykatës që të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër nëse, ndër të tjera, kërkesa e një parashtruesi është e paplotë dhe e paqartë, përkundër kërkesave të Gjykatës për të plotësuar dhe qartësuar kërkesën përkatëse. Gjykata i është drejtuar parashtruesit të kërkesës dy herë me një kërkesë të tillë, pa sukses.
31. Gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret, është e paqartë (i) cilin akt të autoritetit publik parashtruesi i kërkesës e konteston para Gjykatës; (ii) cilat janë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për cenimin e të drejtave dhe lirive të tij kushtetuese; dhe (iii) bazuar në shkresat e lëndës dhe përmbajtjen e tyre, faktet e rastit janë të pakuptueshme.

32. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak se është e paplotë dhe e paqartë, siç është përcaktuar në paragrafin (5) të rregullit 35 të Rregullores së punës.
33. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesave të Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, i refuzon këto kërkesa me procedurë të shkurtër. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI48/17, me parashtruese *Sladana Radojković-Marinković*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 21; dhe KI74/18, me parashtrues *Gëzim Murati*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 3 dhjetorit 2018, paragrafi 26).
34. Përfundimisht, në përputhje me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 22, 47 e 48 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, më 11 nëntor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi